

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

SUBJEKTI: UNIEURO SHPK

NIPT: K71814508A

ADMINISTRATORI: ARIAN GJYZELI

PERMBAJTJA

1- HYRJE

2- Informacion mbi shoqerine

3- Pershkrimi i projektit dhe veprimtarise

4- Pershkrimi i vendit dhe mjedisit

5- Masat zbutese te ndikimeve negative

6- Konkluzione dhe rekomandime

1. HYRJJE

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i Burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje problem mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Sebashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme. Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne. Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithë perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithë. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore. Aktiviteti te cilin ne do te trajtojme eshte "Prodhim canta kartoni dhe pelhure" me material te ardhur nga italia, i cili i vjen ne ndihme industrise tekstile.

Pasqyra e te dhënave kryesore

Projekti: Prodhim i cantave te kartonit dhe pelhures

Me vendndodhje: Fshati Vrrine, prane nenstacionit Fllake, Rrashbulle, Durres

Kompania zhvilluese: "UNIEURO" sh.p.k

2-INFORMACION MBI SHOQERINE

Subjekti i cili do te zhvilloj aktivitetin "Prodhim canta kartoni dhe pelhure" eshte "UNIEURO" shpk regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT K71814508A, forma ligjore

SHPK. Subjekti zhvillon aktivitetin e prodhimit te cantave te kartonit dhe pelhures, me material qe vjen i gatshem nga Italia. Duke qene se ky produkt i kerkuar dhe i perdorur gjeresisht ne te gjitha dyqanet e medha te modes. Kjo shoqeri ka ushtruar dhe do te ushtroi kete aktivitet ne Fshatin Vrrine, prane nenstacionit Fllake, Rrashbulle, Durres. UNIEURO ka qene me pare i paisur me Leje Mjedisi Tipi C.



3-PERSHKRIMI I PROJEKTIT DHE VEPRIMTARISE

Qellimi i zhvillimit te projektit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte prodhimi i cantave prej kartoni dhe pelhure.

Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne prodhimin e produktit perfundimtar do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

Vendodhja e projektit

Zgjedhja e shoqerise per vendosjen e ushtrimit te ketij aktiviteti eshte fshati Vrrine, prane nenstacionit Fllake, Rrashbulle, Durres. aktiviteti do te vendoset brenda siperfaqes se ambjentit ne fjale qe eshte nje siperfaqe ndertese prej 1008 m². Sipas natyres se operacineve qe realizojne teknologjia e projektit perbehet nga sere linjash te ndryshme: qepje/ngjitje, stampim me boje etj.

4- PERSHKRIMI I VENDIT DHE MJEDISIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Zona ku do te zbatohet projekti, tashme mund të përkufizohet fizikisht dhe konceptualisht si një zone me potencial zhvillimi. Kjo zone zhvillohet ne relief fushor. Studimi i propozuar do te zhvillohet ne nje zone me pritshmëri ruajtjen e destinacionit universal te përdorimit: per qëllime komerciale dhe industriale.

Karakteristika te pergjithshme te zones

Bimësia.

Zona ku do te vendoset impainti i prodhimit te betonushtrohet aktiviteti ne fjale eshte nje zone kryesisht e zhveshur nga gjelberimi, dhe pse UNIEURO ne po te njejten vendodhje ka operuar edhe me pare i pasur me Leje Mjedisi C por qe nuk arriti ne kohe te bente kalimin e Lejes nga C ne B dhe per kete po ndjek proceduren si per leje te re mjedisi.

5-MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate procesit te prodhimit te cantave, si te pluhurit ne ajer dhe zhurmave.

➤ Parandalim

Perzgjedhja e teknologjise me cikël te mbyllur me pajtueshmeri mjedisore

- Instalimi korrekt i paisjeve, sipas skemes teknologjike te procesit te punes
- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit
- Ambjentet e punes duhet te jene te pastra;
- Kontroll i vazhdueshem dhe mirembajtje e sistemit te aspirimit te kapjes se pluhurit;
- Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj;
- Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjithë teknologjise se projektit, sistem i qarrkullimit te produktit qe prodhohet;
- Testimi periodik i teknologjise per difekte teknike;

➤ Kontroll

- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash;
- Pastrim dhe mirembajtje e ambjenteve te punes
- Magazinimi i lendeve te para duhet te jete i sistemuar

➤ **Nderhyrje**

- Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike ne aktivitet
- Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale
- Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca)

➤ **Administrim**

- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi e te gjithe infrastruktures dhe mjeteve sipas skemes dhe rregullave teknologjike.

• **Menaxhimi i mbetjeve ngurta**

Administrata dhe punonjesit e ketij aktiviteti do ti kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga shperndarja dhe hedhja pa kriter e mbetjeve etj. Ne mjediset e aktivitetit jane vendosur kosha te grumbullimit te mbetjeve te krijuara nga konsumi i perditshem i punonjeseve. Mbetjet shoqeria do ti dergoje sipas nje marreveshje me njesine administrative te zones ne fjale ne pike grumbullimin e mbetjeve urbane te zones. Gjithashtu ne kete aktivitet mund te ket dhe gjenerim te mbetjeve qe vijne nga procesi i punes, keto lloj mbetjesh ne varesi te llojit te tyre do te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara sipas kontrata dy paleshe.

• **Menaxhimi i mbetjeve te lengta**

Mbetjet e lengeta jane ujrat qe shkarkohen nga nyjet higjeno-sanitare te cilat do te shkarkohen ne grope septike e cila do te pastrohet sa here te jete e nevojshme ne bashkepunim me instancat perkatese.

• **Programi i monitorimit dhe elementet e tij**

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (AKM, etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne Agjensine Kombetare te Mjedisit sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve ne fuqi.

6-KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Perfundime

- Zbatimi i projektit nuk do të ketë pasoja negative të mundshme në mjedisin e zonës.
- Procesi teknologjik i prodhimit të cantave prej kartoni dhe pelhure nuk shoqërohet me shkarkime të mëdha të rrezikshme.
- Ky aktivitet nuk perdore lende të rrezikshme për shëndetin e punonjësve si dhe të popullsisë përreth zonës dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.
- Ky projekt nuk sjell emetime të gazeve në atmosferë.
- Niveli i zhurmave që vijnë nga procesi i punës janë brenda normave të lejuara. Nuk përbejnë problem shqetësues për punonjësit dhe as për banorët e zonës përreth që janë në një distancë të konsiderueshme.
- Furnizimi me energji elektrike do të sigurohet nga rrjeti ekzistues që mbulon zonën duke përdorur të gjitha kushtet teknike.
- Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zonë e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore, pra nuk kemi ndryshime apo dëmtime të saj duke qenë se nuk ekziston në këtë territor.
- Për një punë sa më optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punëtorët e manovratorët njihen me këto rregulla në mënyrë periodike nga drejtuesit teknik të kantierit.

Rekomandime

Duke ditur se gjatë proceseve të punës mund të emetohet në mjedis pluhur i lehtë, ka zhumë të makinerive për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe për të ulur në maksimum impaktin në mjedis, duhet të:

- Të bëhet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike të pajisjeve
- Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis.
- Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të pluhurit në ajër.
- Të njihen punonjësit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik,
- Të menaxhohen mbetjet e ngurta urbane në bashkëpunim me Njësine e Qeverisjes Vendore.
- Të menaxhohen mbetjet teknologjike në bashkëpunim me subjekte të licencuara.
- Të mirëmbahen dhe të pastrohen rregullisht ambientet ku ushtrohet aktiviteti
- Të vendosen kosha dhe postera sensibilizues për mbajtjen pastër të ambienteve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vena në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
- Subjekti të jetë në dijeni të kuadrit ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.

- Te kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve ne fuqi dhe te dergohet nje relacion shkresor cdo 6 muaj prane Agjencise Kombetare te Mjedisit. Te respektohen normat e teknikes se sigurimit ne pune nga punonjesit.